



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

BASHKIA KORÇE  
NR 2380 PROT  
DATA 15/03/2025

Nr \_\_\_\_\_ prot

Korçë më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

## RELACION

### PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, propozojmë të bëhen një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 158 datë 26.11.2024 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundrvajtjet administrative për vitin 2025” si më poshtë:

➤ **Propozim për përjashtim nga pagesa e tarifës për vizitë në kullën panoramike për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara**

Referuar VKB nr. 158 datë 26.11.2024 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundervajtjet administrative për vitin 2025” në Kapitullin VI Tarifa të institucioneve të varësisë për zërin “vizitë në kullën panoramike” permendur në faqën nr. 50 propozojmë përjashtim nga pagesa e tarifës për vizitë në kullën panoramike për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Duke marrë shkak nga seanca dëgjimore e realizuar në datë 19.12.2024 në mjediset e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe bazuar në angazhimin tonë për të siguruar akses të barabartë dhe mundësi vizite për të gjitha kategoritë, propozojmë heqjen e tarifës së sipërpermendur. Në këtë mënyrë, vizita do të jetë e lehtë dhe pa kosto shtesë për ata që kanë nevoja speciale, edhe pse kulla panoramike nuk klasifikohet si institucion kulturor por është një atraksion që tërheq vazhdimisht vizitorë të rinj, mendojmë se ky përjashtim do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e këtij atraksioni.

Drejtoresha e Drejtorisë së Përgjithshme  
Juridike dhe të Menaxhimit  
të Burimeve Njerëzore  
Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike  
Ilirjan Dinellari

Drejtoresha e Taksave dhe Tarifave Vendore

Soniël Prifti

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

## KËSHILLI I BASHKISË

### V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2025

### **PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

## KËSHILLI I BASHKISË

### V E N D O S I

1. Të miratojë, ndryshimin në vendimin nr. 158 datë 26.11.2024 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025” si më poshtë:

**Në Kapitullin VI, Tarifa të Institucioneve të Varësisë, 6.1 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë.**

#### **Të shtohet:**

Përfshihen nga pagesa e tarifës për vizitë në kullën panoramike kategoria e personave me aftësi të kufizuara.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R**

**Ana Verushi**